



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ZHVILLIMIT URBAN

AGJENSIA E LEGALIZIMIT, URBANIZIMIT DHE INTEGRIMIT TE ZONAVE/NDERTIMEVE INFORMALE

RAPORT
I ANALIZËS SË VEPRIMTARISË PËR VITIN 2016

ALUIZNI

AGJENCIA E LEGALIZIMIT, URBANIZIMIT DHE INTEGRIMIT TË
ZONAVE/NDËRTIMEVE INFORMALE

20 JANAR 2017

PERMBAJTJA

I. BILANCI I VEPRIMTARISË

A. TREGUESIT E LEGALIZIMIT TË NDËRTIMEVE PA LEJE.

B. MIRATIMI I AKTEVE NËNLIGJORE

C. MIRATIMI I ZONAVE INFORMALE

Ç. BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONET E PËRFSHIRA NË PROCESIN E LEGALIZIMIT.

D. SITUATA FINANCIARE, ORGANIZIMI I BRENDSHËM DHE BURIMET NJERËZORE.

DH. VEPRIMTARIA E AUDITIT TË BRENDSHËM.

II. MANGËSITË DHE MOSREALIZIMET

III. OBJEKTIVAT E INSTITUCIONIT

I. BILANCI I VEPRIMTARISË

A.TREGUESIT E LEGALIZIMIT TË NDËRTIMEVE PA LEJE.


1. Përpunimi i të dhënave të aplikimeve për legalizim ndërtimi pa leje.

Gjatë vitit 2016, pas përfundimit të fushatave të aplikimit për legalizimin e ndërtimeve pa leje (ajo e vitit 2014 dhe 2015), nga struktura e përpunimit të të dhënave, u bë e mundur rezultatja e një shifre përfundimtare të ndërtimeve informale në territorin e Republikës. Kjo rezultante u llogarit si diferencë e numrit të aplikimeve për legalizim, me dublikimet (përsëritjet) e aplikimeve disa herë për të njëjtin ndërtim pa leje, të cilat janë **në nivelet 25-30% të numrit të përgjithshëm të aplikimeve**.

Në mënyrë analitike numri i ndërtimeve të përfshirë në procedurë sipas viteve të aplikimit dhe shpërndarë sipas qarqeve, paraqitet në tabelën 1 dhe grafikun në vijim:

QARKU	2005	2006	2013	2014	2015	Nr. i Përgjithshëm (-30%)
BERAT	2,249	5,092	519	8,077	477	11,490
DIBËR	65	1,410	181	2,299	283	2,967
DURRËS	13,233	25,183	4,574	24,737	5,400	51,189
ELBASAN	6,808	12,984	3,755	22,287	1,202	32,925
FIER	2,556	25,992	1,934	24,863	1,413	39,731
GJIROKASTËR	190	1,738	199	2,660	513	3,710
KORÇË	3,828	6,114	1,034	6,392	787	12,709
KUKËS	201	1,819	181	1,452	193	2,692
LEZHË	2,701	8,519	2,357	8,910	1,177	16,565
SHKODËR	1,527	16,566	2,691	13,031	1,322	24,596
VLORË	6,696	16,730	2,498	10,795	1,272	26,594
TIRANË	23,946	64,795	4,131	36,990	10,018	97,916
TOTAL	64,000	186,942	24,054	162,493	24,057	323,082

Tabela 1



2. Procedurat e përditësimit në terren dhe hartimi i dokumentacionit teknik.


Gjatë periudhës një vjecare është kryer evidentimi faktik në terren për **71.154** ndërtime pa leje. Si një ndër procedurat kryesore, ajo përfshin përditësimin në terren të gjendjes faktike ndërtimore të objektit dhe plotësimin e hartimit i dokumentacionit tekniko-ligjor (proces verbal, genplan, planimetri, hartë e përditësuar e zonës kadastrale, etj.).

Ky tregues i rëndësishëm për finalizimin e procedurës së legalizimit ka njohur rritje nga viti në vit dhe tashmë, me objektet e evidentuara **gjatë vitit 2016**, kjo procedurë **ka përfunduar për mbi 85%** të ndërtimeve informale, të përfshira në procesin e legalizimit.

Në vijim paraqitet në formë tabelare dhe grafike ecuria në vite e këtij treguesi.

EVIDENTIMI NE TERREN					
2006 - 2013	2014	2015	2016	2014 - 2016	TOTAL
46.037	64.138	74.510	71.124	209.772	255.809

Tabela 2



3. Lejet e legalizimit

Në kuadër të mirë përcaktimit të një seti procedurash dhe afatesh konkrete, përmes akteve nënligjore të miratuara gjatë vitit 2016, u bë i mundur përsheptimi i ritmeve të procesit, duke legalizuar **51.351 ndërtime** (numri më i lartë i legalizimeve që prej fillimit të procesit).

Në një analizë krahasuese të performancës së Agjencisë gjatë tre viteve (2014-2016) numri i lejeve të legalizimit arriti në **88.393**, (4 herë më shumë se 8 vitet e qeverisjes së mëparshme) duke e cuar numrin e përgjithshëm të objekteve të legalizuara në **110.143**.

Tabela 3 dhe grafiku në vijim paraqesin numrin e lejeve sipas viteve.

LEJE LEGALIZIMI SIPAS VITEVE								
2006-2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	TOTAL
2.023	1.819	3.625	6.507	7.776	15.294	21.748	51.351	110.143

Tabela 3




Ecurinë më të mirë, në legalizimin e ndërtimeve informale edhe gjatë vitit 2016, e kanë drejtoritë e ALUIZNI-t të qarkut **Fier, Durrës, Tiranë dhe Elbasan.**

Më poshtë paraqitja grafike e **performancës sipas qarqeve**, për sa i përket këtij treguesi, gjatë viteve.

QARKU	2006-2013	2014	2015	2016	2014-2016	NUMRI I PERGJ.
BERAT	1.377	431	477	269	1.177	2.554
DIBER	317	46	173	508	727	1.044
DURRËS	2.728	3.386	5.885	12.917	22.188	24.616
ELBASAN	2.071	1.553	1.007	4.671	7.231	8.942
FIER	1.708	2.698	2.443	6.323	11.464	12.837
GJIROKASTËR	328	361	397	614	1.372	1.700
KORÇË	842	152	998	780	1.930	2.772
KUKËS	341	291	266	187	744	1.085
LEZHË	1.427	792	1.222	3.740	5.754	6.881
SHKODËR	1.403	1.033	1.377	3.520	5.930	6.979
TIRANË	6.466	3.371	6.623	16.023	26.017	34.132
VLORË	2.742	1.180	880	1.799	3.859	6.601
TOTAL	21.750	15.294	21.748	51.351	88.393	110.143

Tabela e numrit të lejeve të legalizimit sipas qarqeve.



4. Ndërtimet e përjashtuara nga legalizimi

Gjatë vitit 2016 janë kryer procedurat administrative të përjashtimit për **405 ndërtime**, të cilat nuk përmbushin kushtet për legalizim, sipas nenit 39 të ligjit nr.9482/2006 “Për legalizimin,...” dhe VKM nr.280/2014.

Në funksion të një tabloje të qartë të gjendjes së objekteve të kundraligjshme, për të cilat ka një vendimmarrje nga IKMT, në bazë të ligjit nr.9780/2007, “Për inspektimin e ndërtimit”, i ndryshuar, ALUIZNI ka ndërrmarrë iniciativën për përgatitjen e një informacioni të plotë dhe të saktë, mbi numrin e objekteve të prishura si të kundraligjshme, që janë përfshirë në procesin e legalizimit.

5. Kalimi i të së drejtës së pronësisë dhe kompensimi i pronarëve.

Në përputhje me detyrimet e përcaktuara në ligjin nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, nga strukturat përgjegjëse në qarqe dhe Drejtoria e Cështjeve të Pronësisë në Drejtorinë e Përgjithshme të ALUIZNI-t, është hartuar dokumentacioni i nevojshëm i cili ka rezultuar në miratimin nga Këshilli i Ministrave, vetëm gjatë vitit 2016 të:

- Kalimit të së drejtës së pronësisë për **3244 parcela ndërtimore**, të zëna nga ndërtimet pa leje;
- Ndryshimit, korigjimit të konfigurimit dhe sipërfaqes për **550 parcela ndërtimore**.
- Shpërblimit financiar të **493 subjekteve**, pronarë të pasurive të paluajtshme, të prekura nga ndërtimet pa leje, me vlerë të përgjithshme prej **3.184.494.567** lekë.

B. MIRATIMI I AKTEVE NËNLIGJORE

Aktet normative të miratuara gjatë vitit 2016, të hartuara nga ALUIZNI dhe gjendja e projektakteve paraqiten në vijim.

Akte të miratuara.

Ligje

1. Ligj nr. 73/2016, datë 14.7.2016 “Për një ndryshim dhe shtesë në ligjin nr. 9232, datë 13.5.2004, “Për programet sociale të strehimit”, të ndryshuar”.

Vendime të Këshillit të Ministrave

2. VKM nr. 130, datë 17.2.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 289, datë 17.5.2006, të Këshillit të Ministrave, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale (ALUIZNI)”, të ndryshuar” (në bazë të nenit 23 të ligjit).

3. VKM nr. 182, datë 9.3.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 860, datë 10.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim””. (në bazë të neneve 32, pika 3, e 43, pika 2 të ligjit)

4. VKM nr. 465, datë 22.6.2016 “Për përcaktimin e procedurave dhe rregullave për kalimin e së drejtës së pronësisë mbi parcelën ndërtimore të objekteve informale”. (në bazë të nenit 17, pika 1, të ligjit)

5. VKM nr. 634, datë 07.09.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 589, datë 10.9.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat e evidentimit faktik të situatës ndërtimore në terren, si dhe të periudhës kohore brenda së cilës janë ndërtuar objektet pa leje” (në bazë të nenit 17, pika 1, shkronja “d” e ligjit)
6. VKM nr. 660, datë 21.09.2016 “Për disa shtesa në vendimin nr.954, datë 25.11.2015 të këshillit të ministrave “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave dhe të formularit të lejes së legalizimit”, të ndryshuar”. (në bazë të nenit 28 të ligjit)
7. VKM nr. 756, datë 26.10.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 280, datë 1.4.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”. (në bazë të nenit 39 të ligjit).
8. VKM nr. 828, datë 23.11.2016 “Për përcaktimin e procedurave dhe të afateve për kalimin e së drejtës së pronësisë, pa pagesë, mbi truallin dhe objektet e ndërtuara për familjet e shpërngulura nga ndërtimi i Ujëmbledhësit të Bovillës”. (në bazë të nenit 39/1, të ligjit nr. 9232, datë 13.5.2004, “Për programet sociale të strehimit”).
9. VKM nr. 19, datë 11.1.2017 “Për përcaktimin e rregullave të legalizimit të objekteve me leje ndërtimi, në të cilat janë kryer shtesa anësore dhe/ose në lartësi ose ndryshime të funksionit të hapësirave dhe të objekteve shumëkatëshe pa leje, të destinuara për kalimin e së drejtës së pronësisë apo qiradhënien” (në bazë të neneve 36 dhe 43/1 të ligjit)

Akte në proces miratimi.

1. VKM “Për administrimin e të dhënave mbi ndërtimet informale” (në bazë të nenit 4 të ligjit).
2. VKM “Për disa ndryshime në VKM nr.488, datë 22.7.2014, “Për përcaktimin e çmimit favorizues të shitjes së parcelës ndërtimore...”

C. MIRATIMI I ZONAVE INFORMALE

Një nga prioritetet e ALUIZNI-t ka qenë dhe mbetet identifikimi i zonave informale, formalizimi dhe integrimi i tyre në realitetin urban.

Përcaktimi dhe miratimi i kufirit të zonave, ndihmon për një qasje objektive të fenomenit të informalitetit në raport me premisat dhe dinamikat e zhvillimit urban. Në këtë mënyrë ato jo vetëm kthehen në faktor gjatë procesit të hartimit të dokumenteve të planifikimit të territorit, por edhe u vinë në ndihmë njësive të qeverisjes vendore të saktësojnë prioritetet në lidhje me projektet e urbanizimit. Për këtë qëllim u identifikuan dhe miratuan me miratim në Këshillin e Rregullimit të Territorit, **277 zona informale**, me një sipërfaqe të përgjithshme prej **19.300** ha, të shpërndara në gjithë territorin e Shqipërisë.

Vlerësohet se ndërtimet pa leje në këto zona është rreth **200.000**, me një numër të përafërt prej **300.000 familjesh**.

Urbanizimi i zonave informale po vlerësohet gjithnjë e më shumë nga ana e Agjencisë krahas legalizimit. ALUIZNI gjatë vitit 2016 e në vijim po luan një rol konkret dhe të drejtpërdrejtë në procesin e hartimit të planeve vendore, në bashkëpunim të ngushtë me Agjencinë Kombëtare të Planifikimit të Territorit.

Parimet kryesore të pjesëmarrjes së Institucionit lidhen me; vënien në dispozicion të informacionit (treguesve) që disponon, në mënyrë që t’ju vijë në ndihmë studiove projektuese hartuese të planeve; ndërgjegjesimi i aktorëve kyç në procesin e planifikimit të territorit, për të përfshirë plotësisht realitetin e ndërtimeve informale në suazat e planifikimit.

Ç. BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONET E PËRFSHIRA NË PROCESIN E LEGALIZIMIT.

Një ndër objektivat e ALUIZNI-t gjatë vitit 2016 ka qenë intensifikimi i dhe rritja e nivelit të bashkërendimit me institucionet e përfshira në procesin e legalizimit të ndërtimeve informale. Kjo përfshirje ka të bëjë qoftë me trajtimin efikas dhe në kohë, të një numri sa më të madh të objekteve informale, me problematika që lidhen me institucione të tjera, por edhe me zbatimin e angazhimit, për një proces legalizimi falas.

Përmendim këtu ndërveprimin me institucionet qendore, si:

- Ministria e Mbrojtjes,
- Ministria e Drejtësisë,
- Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës,
- Ministria e Kulturës,
- Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë;

por në mënyrë të veçantë institucionet ligjzbatuese, si:

- Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme,
- Agjencia e Trajtimit të Pronave,
- Instituti i Monumenteve të Kulturës,
- Enti Kombëtar i Banesave,
- Agjencia Kombëtare e Mjedisit, etj.

Në këtë drejtim, do të konsideronim si histori suksesi:

- aplikimin e skemës faljes së pagesës së truallit për kategoritë në nevojë si personat me aftësi të kufizuara, që kanë statusin e të verbërit, invalidit të punës, subjektete e ndihmës ekonomike etj.,
- trajtimin dhe përfshirjen në skemën e legalizimit të një numri familjesh të vendosura në objektet ish-ushtarake,
- bashkërendimin dhe shkëmbimin e informacionit në procesin e vendimmarrjes për miratimin e zonave të mbrojtura mjedisore,
- nxitjen e banorëve të zonave informale për tu përfshirë në skemën e pagimit të energjisë elektrike, duke përdorur bonuse në vlerën e truallit të legalizuar,
- nisjen e procesit të unifikimit dhe korrigjimit të informacionit hartografik të zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme sipas hartës së fotografimit ajror dhe të përdorur nga ALUIZNI,
- mirëfunksionimin e skemës së shpërblimit financiar të pronarëve, pronat e të cilëve janë zënë nga ndërtimet informale,

D. SITUATA FINANCIARE, ORGANIZIMI I BRENDSHËM DHE BURIMET NJERËZORE.

1. Planifikimi, menaxhimi dhe monitorimi i shpenzimeve publike.

Aktivitetet kryesore të ndërmarra për arritjen e këtij objekti, gjatë vitit 2016, sipas fushave kryesore të buxhetimit, përmbledhen në:

a) Ne fushen e planifikimit buxhetor.

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, të udhëzimit nr. 4, datë 29.02.2016, "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2017-2019", dhe tavanëve të detajuara nga MZHU-ja u përgatit programi buxhetor afatmesëm, PBA 2017-2019, si dhe projekt buxheti për vitin 2016. Në vija të përgjithshme kërkesat për PBA 2017-2019, janë hartuar dhe paraqitur konform procedurave standarte të përgatitjes së tyre. Për realizimin e detyrës së rëndësishme të planifikimit buxhetor, me urdhër të titullarit të institucionit, u ngrit dhe funksionon grupi i menaxhimit strategjik të ALUIZNI-t.

Pas miratimit nga Kuvendi, të ligjit të buxhetit të vitit 2016 dhe në zbatim të udhëzimit të Ministrit të Financave, nga ana e Drejtorisë së Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, u bë detajimi i fondeve buxhetore, përgatitja e limiteve mujore (planit të arkës) sipas drejtorive të varësisë të ALUIZNI-t, miratimi nga MZHU dhe Ministria e Financave. E njëjta procedurë u realizua edhe për numrin e punonjesve, të miratuar për ALUIZNI-n në ligjin e buxhetit të vitit 2016. Si rezultat, Drejtoria e Përgjithshme dhe të gjitha drejtoritë e varësisë së ALUIZNI-t, filluan vitin e ri buxhetor me fonde dhe numër punonjësish të miratuar në përputhje me procedurat dhe afatet ligjore.

Në janar të vitit 2016 janë paraqitur të argumentuara në MZHU dhe Ministrinë e Financave kërkesa për punonjës me kontratë të përkohshme, për drejtoritë e varësisë dhe është bërë miratimi i tyre nëpërmjet vendimeve të Këshillit të Ministrave për një numër total prej 308 punonjësish. Për nevoja të institucionit, u ndoq e njëjta procedurë në gjashtë mujorin e dytë të vitit 2016 duke u shtuar një kontigjent prej 400 punonjësish me kontratë, në varësi të arkëtimit të të ardhurave.

b) Në fushën e menaxhimit dhe monitorimit të fondeve publike.

Nga ana e Drejtorisë së Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse është bërë ndjekja periodike e realizimit të shpenzimeve buxhetore gjatë vitit 2016, për Drejtorinë e Përgjithshme dhe të gjitha drejtoritë e varësisë së ALUIZNI-t. Në përmbushje të detyrimit ligjor janë përgatitur periodikisht, cdo tremujor, raportet e monitorimit të shpenzimeve buxhetore, të cilat janë dërguar në MZHU, sipas kërkesës në udhëzimin e zbatimit të buxhetit të Ministrit të Financave.

Për vitin 2016, ALUIZNI administron dhe menaxhon fondet buxhetore, sipas dy programeve të miratuara e konkretisht:

- Shpenzimet
- Investimet Publike

Për vitin 2016, realizimi i shpenzimeve operative "Mallra dhe shërbime", për Drejtorinë e Përgjithshme dhe drejtoritë e varësisë të ALUIZNI-t është sipas tabelës së mëposhtme:

Nr	Drejtorite	Planifikimi	Realizimi	%
1	Berat	2,836,492	2,533,874	90
2	Diber	1,764,431	1,753,634	100
3	Durres	5,229,620	5,225,800	100
4	Elbasan	3,423,000	3,422,873	100
5	Fier	6,232,274	5,923,570	95
6	Gjirokaster	1,744,785	1,732,785	100
7	Kavaje	842,900	836,952	99.4
8	Kruje	676,110	671,200	99.2
9	Korce	3,650,450	3,563,175	98
10	Kukes	1,800,000	1,800,000	100
11	Lezhe	1,630,980	1,595,972	98
12	Lushnje	850,970	829,969	99
13	Shkoder	2,400,000	2,400,000	100
14	Vlore	5,579,652	5,518,085	99
15	Sarande	1,070,000	1,064,272	100
16	Tirane Veri	4,300,000	4,270,578	99.3
17	Tirane Jug	2,189,500	2,184,526	99.8
18	Tirane- 2	900,000	881,678	98
19	Tirane Rurale	4,000,486	3,965,489	99
20	Zonat Turistike	782,000	752,973	96
21	Kamez Vore	2,600,000	2,559,037	100
22	D. Pergjithshme	19,147,856	19,147,632	100
	TOTALI	73,656,024	72,631,074	98.6

Shpenzimet operative faktike gjatë vitit 2016, janë realizuar në rreth 97% nga fondet e alokuara nga buxheti i shtetit.

Drejtoritë tona për shpenzimet “Mallra dhe shërbime” kanë përdorur edhe fonde nga të ardhurat, të cilat i kanë ndihmuar në vazhdimësinë e procesit sipas tabelës së mëposhtme:

Nr	Drejtorite	Realizimi	Detyrime te vitit 2015 per Evidentimi ne terren	Evidentimi ne terren me siper marrje	% realizimit te evidentimit ne terren
1	Berat	2,346,520	2,346,520		
2	Diber	506,100			
3	Durres	62,094,877		60,000,000	100
4	Elbasan	11,110,000		9,600,000	100
5	Fier	639,781			
6	Gjirokaster	321,910			
7	Kavaje				
8	Kruje				
9	Korce	511,505			
10	Kukes	444,000			
11	Lezhe	1,451,832			
12	Lushnje	9,600,000		9,600,000	100
13	Shkoder				
14	Vlore	13,641,480		8,819,016	92
15	Sarande				
16	Tirane Veri	15,950,531	12,000,000		
17	Tirane Jug	4,447,723	3,816,000		
18	Tirane2	1,698,324			
19	Tirane Rurale	7,431,860		6,508,512	68
20	Zonat Turistike	6,163,184		6,045,000	63
21	Kamez Vore	23,079,007	20,000,000		
22	D. Pergjithshme				
	TOTALI	161,438,634	38,162,520	100,572,528	93

Brenda totalit të shpenzimeve të përgjithshme, shpenzimet “Mallra dhe shërbime”, që përfaqësojnë rreth 27%, janë realizuar në rreth 99%, ndërkohë që shpenzimet për investime që përfaqësojnë rreth 2.7% të tyre, janë realizuar në 96%.

Sipas zërave përbërës, shpenzimet korente janë realizuar siç paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Artiku Ili	Emërtimi	Buxheti 2016			Te Ardhura (Plan/ Fakt)	TOTAL		
		Plan	Fakt	Në %		Plan	Fakt	Në %
600-601	Shpenzime personeli	447,957	444,801	99.3	155,986	603,943	600,787	99.5
602	Shpenzime operative	73,651	72,631	98.6	161,431	235,082	234,062	99.6
603-606	Të tjera shpenzime korente	67	67	100.0		67	67	100.0
	Shpenzime korente	521,675	517,499	99.2	317,417	839,092	834,916	99.5

Zëri investime është realizuar siç paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Nr	Drejtoria	Planifikimi	Realizimi	Në%
1	Berat	411,600	411,600	100.0
2	Diber	240,000	201,600	84.0
3	Durres	480,000	472,480	98.4
4	Elbasan	693,120	693,120	100.0
5	Fier	612,900	612,900	100.0
6	Gjirokaster	240,000	0	0.0
7	Kavaje	678,500	655,200	96.6
8	Kruje	782,800	661,200	84.5
9	Korce	388,680	388,680	100.0
10	Kukes	240,000	233,400	97.3
11	Lezhe	226,400	226,400	100.0
12	Lushnje	504,800	504,800	100.0
13	Shkoder	240,000	237,000	98.8
14	Vlore	480,000	472,668	98.5
15	Sarande	480,000	167,760	35.0
16	Tirana Veri	480,000	480,000	100.0
17	Tirane Jug	589,600	557,040	94.5
18	Tirana Rurale	1,340,000	1,209,000	90.2
19	Zonat Turistike	480,000	454,600	94.7
20	Kamez-Vore	480,000	417,060	86.9
21	Drejtoria Pergjithshme	13,804,900	13,788,082	99.9
	TOTALI	23,973,300	22,956,606	96

Për monitorim dhe menaxhim me te mire te shpenzimeve, ne vecanti te investimeve, u është kerkuar drejtorive te varesise raportim ditor i performances se shpenzimeve buxhetore, duke evidentuar edhe fazat e vecanta ne te cilat ndodhet shpenzimi.

Nga analiza e shpenzimeve buxhetore sipas programeve rezulton:

Shpenzimet gjithsej për programin **“Planifikim, Menaxhim, Administrim”** në buxhetin e vitit 2016 zene rreth 63.2% të shpenzimeve totale të ALUIZNI-t dhe për këtë vit kanë një realizim prej rreth 99%, nga të cilat shpenzimet operative rreth 98.6% dhe investimet publike, rreth 96%.

• Shpenzimet korente sipas klasifikimit ekonomik rezultojnë në këto nivele realizimi për vitin 2016:

1.	Shpenzimet për paga	99 përqind
2.	Shpenzimet për sigurimet shoqërore	98 përqind
3.	Shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes	98.6 përqind
4.	Shpenzimet për transferatë tek individët	100 përqind

• Investimet publike me financim të brendshëm për Programin “Planifikim,

Menaxhim, Administrim”, në buxhetin e vitit 2017 në vlerën 234 milionë lekë u shpërndanë në 5 projekte si më poshtë:

1. Blerje servera, me vlerë 10.8 milionë lekë, u realizua me tender të hapur nga Ministria e Brendshme, për 7,486.000 lekë, dhe pjesa e mbetur u realizua me procedurën “Blerje e vogël” nga të gjitha drejtoritë e varesisë në masën 97%
2. Blerje pajisje zyre me vlerë 1.9 milionë lekë, u realizua me procedurën “Blerje e vogël” nga të gjitha drejtoritë e varesisë i realizuar në masën 79%
3. Blerje automjete, me vlerë 2.8 milionë lekë, u realizua me tender të hapur nga Ministria e Brendshme

Përdorimi i fondit të vecantë, për vitin 2016 është bërë në përputhje me kriteret e përcaktuara në vendimet përkatëse të përdorimit të tij, si dhe është dhënë përgjigje institucioneve të varesisë për problematikat e vecanta të ngritura nga ana e tyre.

Nga ana e ALUIZNI-t, gjatë vitit 2016, janë ndjekur të gjitha procedurat e përcaktuara në ligjin e menaxhimit financiar për miratimin e nepunesve autorizues dhe zbatues të drejtorive të varesisë sipas nevojave të tyre.

Gjatë vitit 2016 ka realizuar të ardhura nga procesi i legalizimit sipas tabelës më poshtë vijon:

N R	DREJTORI A	VLERA E PARCELES NDERT.	TARIFE SHERBIMI	PENALITE T VETE DEKLARIM	PENALITET SUBJEKT NDERTUES	TOTALI	ARKETIME BONO PRIVATIZIMI
1	Berat	13,824,348	2,031,850		0	15,856,198	22,450,000
2	Diber	6,650,207	1,260,000	620	0	7,910,827	9,500,000
3	Durres	406,464,038	8,840,000	2,758,141	8,733,964	426,796,143	531,771,600
4	Elbasan	97,632,087	8,940,000	0	461,187	107,033,274	108,440,000
5	Fier	81,656,048	3,202,660	625,265		85,483,973	112,540,000
6	Gjirokaster	14,169,558	1,822,603			15,992,161	18,100,000
7	Kavaje	13,459,514	336,533	157,618		13,953,665	17,125,000
8	Kruje	1,742,648	304,000	187,000	114,301	2,347,949	4,220,000
9	Korce	6,846,181	1,348,000	273,035	3,027,310	11,494,526	9,065,000
10	Kukes	14,124,629	424,000	20,430	0	14,569,059	19,650,000
11	Lezhe	44,518,350	4,232,000	1,181,430	1,781,300	51,713,080	72,741,000
12	Lushnje	14,787,409	1,376,000	1,027,125		17,190,534	15,409,000
13	Shkoder	54,393,597	3,462,000	169,638	3,378,137	61,403,372	85,850,000
14	Vlore	202,557,385	1,878,100	0	2,434,895	206,870,380	279,179,000
15	Sarande	42,075,675	1,800,000	0	2,196,095	46,071,770	51,292,000
16	Tirane Veri	401,289,211	2,448,000	2,009,610		406,441,821	762,430,000
17	Tirana Jug	51,307,026	1,104,000	973,763	2,414,230	55,799,019	
18	Tirane 2	32,777,200	13,532,397	376,770	14,350,632	51,037,000	5,050,000
19	TR. Rurale	7,929,988	3,063,000	307,485	11,540,097	22,840,570	10,465,000
20	Zonat Turi.	46,012,505	3,784,992	16,483	4,674,806	54,488,786	2,475,000
21	Kamez Vor	93,459,656	3,020,000	1,345,727	14,942,383	112,767,666	16,770,000
	Totali:	1,648,377,262	58,210,135	11,430,140	70,049,238	1,788,066,775	2,123,677,600

Gjatë këtij viti janë transferuar në fondin e kompensimit të pronarëve shuma prej **1.134.595.185 lekë**, nga të ardhurat e arkëtuara nga pagesa e parcelës ndërtimore të objekteve pa leje.

Eshtë transferuar në buxhet shuma prej 170.000.000 leke të akorduara për paga e sigurime shoqërore për punonjësit me kontratë të përkohshme dhe shpenzuar nga drejtorite e varesise për paga, sigurime shoqërore e shpenzime operative 317.417.000 leke.

Jane derdhur ne buxhet te ardhura te paperdorura 172.583.948 leke.

2. Organizimi i brendshëm.

Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale, gjatë vitit 2016, është riorganizuar me Urdhrin nr.58, 05.04.2016 të Kryeministrit, "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Drejtorisë së Përgjithshme të Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale (ALUIZNI) dhe drejtorive në varësi të saj", me fokus kryesor:

- Rritjen e efikasitetit të strukturave, në funksion të përshejtit të procedurave administrative të legalizimit të ndërtimeve pa leje,
- Shkurtimin e shpenzimeve buxhetore të tepërta nëpërmjet rekrutimit të specialistëve me profilin e duhur arsimor
- Transferimin e shërbimit sa më pranë qytetarit duke shpërndarë në territor një numër të konsiderueshëm ekspertësh.

Numri i përgjithshëm i punonjësve të ALUIZNI-t, për vitin 2016, sipas strukturës së miratuar në gjysmën e parë të vitit rezultoi 315 vetë nga 399 që ishte me ndryshimet e fundit strukturore të ndërmarra në gjysmën e dytë të vitit të kaluar.

Me miratimin e strukturës gjatë vitit 2016 u bë një riorganizim i Drejtorive të ALUIZNI-për qarqet Tiranë dhe Durrës me synim decentralizim të procesit të legalizimit, duke u shtuar dy drejtori të reja për qarkun Tiranë që çoi në 7 (shtatë) numrin e drejtorive për këtë Qark dhe një Drejtori të re në qytetin e Krujës për qarkun Durrës. Po ashtu, janë krijuar zyra apo sektorë në drejtoritë egzistuese për të bërë të mundur një akses më të drejtpërdrejtë të qytetarit në procesin e legalizimit, ndryshime këto që kanë rezultuar më se efektive nisur edhe nga rezultati i deritanishëm i punës së Agjensisë. Aktualisht, ALUIZNI ka gjithsej **21 Drejtori rajonale**, dhe brenda këtyre drejtorive ka krijuar një rrjet të zgjeruar të zyrave, pranë njësive të veçanta të qeverisjes vendore në të gjithë vendin.

ALUIZNI ka raportuar në mënyrë periodike pranë MZHU dhe DAP për të dhënat lidhur me burimet njerëzore, emërimet, lirimet, masat disiplinore dhe vendimet gjyqësore që lidhen me marrëdhëniet e punës.

Për periudhën janar-dhjetor 2016 Institucioni në respektim të dispozitave të Kodit të Punës ka dhënë gjithsej 50 masa disiplinore, nga të cilat 30 "Vërejtje", 9 "Vërejtje me shkrim", 11 "Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna" dhe 6 Lirime nga detyra.

3. Infrastruktura dhe ambientet.

Përsa i përket ambienteve të punës, shumë prej drejtorive kanë sipërfaqe të kufizuara, arsye për të cilën, një pjesë e tyre janë detyruar të sistemohen në ambiente me qira, në pamundësi për të gjetur ambiente të përshtatshme shtetërore.

Për Qarkun e Tiranës gjendja paraqitet me probleme.

3 drejtori janë të sistemuara në ambiente shtetërore, në administrim, të cilat kanë nevojë për investime, për tu bërë sa më të shfrytëzueshme.

2 drejtori janë të sistemuara në ambiente me qira (Drejtoria e ALUIZNI-t Kamëz - Vorë, e vendosur në Kamëz dhe Drejtoria e ALUIZNI- Tirana Rurale e vendosur në zonën e Laprakës) Aktualisht kontrata e qirasë së Drejtorisë e ALUIZNI-t Tirana Rurale ka përfunduar. Marrja e këtyre ambienteve me qira, duke patur parasysh një kosto sa më të ulët në zërin shpenzime për qiranë, nuk jep mundësinë e sigurimit të kushteve optimale dhe po ashtu të kryerjes së investimeve kapitale.

ALUIZNI Berat, me një numër prej 23 punonjësish, ushtron aktivitetin në një hapësirë prej 100m², ambiente këto jashtë kushteve teknike të punës, kryesisht për arsye të lagështirës shumë të madhe.

ALUIZNI Lushnje dhe Kavajë ushtrojnë aktivitetin, në ambiente shtetërore, përkatësisht në 2 dhe 3 zyra dhe kanë nevojë emergjente për ambiente shtesë.

Problematike shfaqet edhe situata në Drejtorinë e ALUIZNI-t Vlorë, zyrat e së cilës janë të vendosura në periferi të qytetit, mjaft larg nga zona e banuar duke vështirësuar tej mase komunikimin me qytetarët.

Për Drejtorinë e Përgjithshme, problem përbën mungesat e hapësirave për Arkivin ku administrohen dokumentacion nga të gjitha drejtoritë e varësisë. Kjo mungesë ka bërë që prej vitit 2013, gjithë dosjet e ndërtimeve informale të pajisura me leje legalizimi, të mos administrohen pranë këtij arkivi.

Për vitin 2017 është miratuar një fond buxhetor, në zërin investime, për shtesë objekti ndërtimor pranë Drejtorisë së Përgjithshme, prej 27.000.000 lekë. Prokurimi i këtij investimi do të lehtësojë situatën problematike aktuale të krijuar nga mungesa e ambienteve të nevojshme të punës.

Problem tjetër i hasur gjatë këtij viti ka qenë mungesat në pajisje kompjuterike dhe pajisje zyre. Gjithë fondi i akorduar në fillim të vitit të kaluar u vu në dispozicion të blerjes së infrastrukturës së serverit të ri.

Për këtë vit fondet e miratuara do të përdoren për plotësimin e nevojave të paraqitura nga drejtoritë rajonale të mbartura në vite.

DH. VEPRIMTARIA E AUDITIT TË BRENDSHËM.

1. Rezultatet e veprimtarisë së Auditit të Brendshëm

Në zbatim të kërkesave të ligjit nr.114, datë 22.10.2015, "Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik" dhe të Manualit të Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave nr.100, datë 25.10.2016, "Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik", Sektori i Auditit të Brendshëm, ka synuar të përfshijë ato subjekte, të cilat lidhen me misionin dhe qëllimin për të cilën ato ushtrojnë veprimtarinë administrative.

Veprimtaria audituese është orientuar në auditimin e sistemeve dhe vlerësimin në thellësi të menaxhimit financiar dhe të kontrollit, të vendosura nga niveli i menaxhimit, me qëllim përcaktimin nëse ato funksionojnë në mënyrë eficiente dhe me kosto efektive, me qëllimin final arritjen e objektivave.

Sipas Planit Vjetor të Auditimit të vitit 2016, (nr.6946, datë 12.10.2015) miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i ALUIZNI-t, u parashikua kryerja e 15 auditimeve të plota. Efektivisht në 2016, janë realizuar 3 auditime të plota dhe 2 auditime tematike, janë evaduar 4 (katër) dosje auditimi dhe 1 (një) është në proces evadimi. Përsa i përket realizimit jo të plotë të programit vjetor të auditimit, kjo ka qenë rrjedhojë e auditimeve që ka ushtruar Kontrolli i Lartë i Shtetit, në drejtoritë e programuara të auditoheshin nga A.B. i ALUIZNI-t, si dhe vlerësimin të njësive që përcaktohen me risk më të lartë dhe me mos realizim të objektivave. Për këto arsye është bërë dhe shmangia nga plani vjetor i auditimit për vitin 2016.

Proçesi i planifikimit ka vijuar të përmirësohet, duke shfrytëzuar eksperiencat më të mira, si dhe duke respektuar me profesionalizëm standartet e auditimit të brendshëm në fushën e planifikimit.

Sektori i Auditit të Brendshëm e ka orientuar përdorimin e burimeve të auditimit drejt fushave me risk të lartë, duke orientuar njësinë drejt përmbushjes së objektivave me kosto sa më të ulët, si dhe me qëllim kontribuimin në arritjen e objektivave dhe programeve strategjike të sistemit financiar publik.

Sektori i Auditimit të Brendshëm do të vijojë të përmirësojë eficientësinë e punës dhe do rrisë asistencën profesionale në ndihmë të përmirësimit të drejtimit dhe shtimit të vlerës së ALUIZNI-t dhe të njësive në vartësi të saj, duke planifikuar për auditim ato struktura varësie, aktivitete apo fusha me risk të lartë, pa lënë mënjanë edhe strukturat e tjera të varësisë.

Në vitin 2016, gjetjet në lidhje me dëmin financiar të shkaktuar, janë në vlerën shumë më **2 844.6 milion lekë**.

Gjatë vitit 2016, janë shqyrtuar një numër i lartë ankesash nga qytetarët, ku për një pjesë e tyre është bërë dhe verifikimin në terren i objekteve pa leje, ku janë hartuar **36 Akt-Konstatime**, duke rekomanduar zgjidhjet përkatëse.

Gjatë vitit 2016, janë shqyrtuar një numër i lartë ankesash nga qytetarët në portalin www.stopkorrupsionit.al. Ka patur denoncime për 157 raste të reja. Nga të cilat janë zgjidhur 68 raste; janë refuzuar 53 raste; janë në proces 36 raste, të cilat kërkojnë në shumicën e tyre skualifikime nga procesi i legalizimeve. Nga ankesat e ardhura në portalin antikorrupsion janë hartuar 25 Akt-Konstatime.

Bazuar në gjetjet e rezultuara sipas auditimeve me bazë sistemi, pranë entiteteve të audituara, për përmirësimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe të organizimit të kontrollit të brendshëm, për periudhën e 12 mujore të vitit 2016, janë dhënë rekomandime, të cilat prekin sistemin e pagave, sistemin e menaxhimit të burimeve njerëzore, sistemet e tjera sipas misionit, qëllimit dhe ligjit organik përkatës si dhe sistemin e kontabilitetit dhe menaxhimit financiar. Këto rekomandime janë kryesisht të karakterit ligjor, organizativ dhe për zhdëmtim, në rastet e konstatimit të dëmeve ekonomike e financiare me synimin për të ulur mundësinë e përsëritjes së këtyre rasteve në të ardhmen.

Procesi i monitorimit dhe sigurimi i cilësisë së AB në Drejtorinë e Përgjithshme të ALUIZNI-t ka qenë e një niveli të kënaqshëm gjatë hartimit dhe mbajtjes së programit kemi siguruar që cilësia e auditimeve të kryera ka qenë e një niveli të mirë të specialistëve të këtij sektori. Auditimi i brendshëm është kryer në bazë të standardeve dhe praktikave profesionale të auditimit të brendshëm, dhe manualit të Auditit të Brendshëm.

Pjesë e rëndësishme e sigurimit të cilësisë është edhe monitorimi dhe rishikimi i jashtëm i veprimtarisë audituese ku Drejtoria e Përgjithshme e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik, ka kryer trajnimet e përvitshme dhe të vazhdueshme në lidhje me standardet e AB si dhe të kontrollit të brendshëm.

II. MANGËSITË DHE MOSREALIZIMET

Pavarësisht se gjatë viti 2016, ALUIZNI ka arritur dhe shpesh, ka tejkaluar objektivat e parashikuara.

-Numri i objekteve të legalizuara Parashikimi në **Projekt Buxhetin Afatmesëm 38.000 legalizimi, realizimi 51.000**),

-arkëtimit të të ardhurave nga procesi (parashikimi në PBA **1 miliard lekë**; realizim rreth **1.8 miliardë lekë**); dhe

-realizimit të investimeve (në masën 96%), mbetet ende hapësirë për përmirësimin e performancës.

Në këtë drejtim, si çështje me ndikim negativ edhe për vitin 2016, kanë qenë:

Mosfunksionimi i shkëmbimit të informacionit dhe jo efikasitet në bashkëpunimin me institucionet e përfshira në mënyrë direkte në procedurat e legalizimit të ndërtimeve informale.

Shembuj konkret në këtë drejtim, kanë qenë problematikat me:

a. ZRPP për mos konkludimin e procesit të unifikimit dhe korigjimit të informacionit hartografik, si dhe me mungesën e informacionit mbi gjendjen juridike të pasurive.

- b. Njësitë e qeverisjes vendore, në aspektin e përfshirjes dhe integritit të zonave informale, në planet e përgjithshme vendore, të miratuara.
- c. Autoritetet shtetërore si Hekurudha Sh.A., Instituti i Monumenteve të Kulturës, Autoriteti Rrugor Shqiptar etj, për vonesat në kryerjen e kualifikimit për legalizim, si pasojë e mungesës së informacionit.

III. OBJEKTIVAT E INSTITUCIONIT

Objektivat e Institucionit për vitin 2017 dhe në perspektivë për të ardhmen e veprimtarisë janë si vijon:

1. Përfundimi i procedurave administrative dhe legalizimi i **40.000** objekteve, duke e çuar numrin e përgjithshëm të lejeve të dhëna në **150.000** në fund të vitit.
2. Pjesëmarrja aktive në urbanizimin dhe integrimin infrastrukturor të zonave informale me ndërtime të legalizuara, qoftë në nivelin e propozimeve në kuadër të miratimit të dokumenteve të planifikimit vendor, qoftë në përfshirjen e drejtpërdrejtë, në projekte specifike urbanizimi.
3. Studimi dhe hartimi i një strategjie, për një qasje sociale ndaj familjeve, banesat e të cilave nuk mund të legalizohen për shkak të ndalimeve ligjore.